

# Reforma e Drejtësisë dhe Gjinia

## PËRMBAJTJA

Pse gjinia është e rëndësishme për reformën e drejtësisë?

Si mundet gjinia të integrohet në reformën e drejtësisë?

Sfidat dhe mundësitë pas – konfliktit

Pyetjet rreth reformës së drejtësisë

Më tepër informata

Egziston një vlerësim i fortë rreth asaj se Reforma Sektorit të Sigurimit (RSS) duhet të plotësoj nevojat e ndryshme të sigurisë për burrat, gratë, djemtë dhe vajzat. Integrimi i çështjeve të gjinisë gjithashtu paraqet çelsin drejt efektshmërisë dhe përgjegjësisë të sektorit të sigurimit, pronës lokale dhe ligjshmërisë të proceseve të RSS-it.

Ky Shënim Praktik siguron një hyrje të shkurtër rreth dobive mbi integrimin e çështjeve të gjinisë në reformën e drejtësisë, gjithashtu edhe informata praktike se si të bëhet.

Ky Shënim Praktik është bazuar në një procedurë më të gjatë, dhe të dyja janë pjesë të **Gjinisë dhe Mjetit Praktik të RSS-it** e dizajnuar për të siguruar një njohje rreth çështjeve të gjinisë për praktikuesit dhe krijuesit e dëftësive të RSS-it, Mjeti Praktik përfshin 12 Mjete përkatëse me Konspektin Praktik – shih në Më tepër informata.

## Pse gjinia është e rëndësishme për reformën e drejtësisë?

**Reforma e drejtësisë** nuk përfshin vetëm reformën e ligjeve por gjithashtu zhvillimin e dëftësive, procedurave dhe mekanizmave që lejojnë implementimin praktik të ligjeve dhe hyrjen e barabartë në sistemin e drejtësisë. Qëllimet e reformës së drejtësisë përfshijnë zhvillimin e: kushtetutës dhe ligjeve të bazuara në standardet internacionale dhe dokumentet ligjore të të drejtave njerëzore; një drejtësi efektive, të paanshme dhe të përgjegjshme; një drejtëm të integruar për drejtësinë penale; dhe mekanizmat për mbikëqyrjen e sistemit të drejtësisë.<sup>1</sup>

**Gjinia** i referohet roleve dhe marrëdhënieve, veçorive të personalitetit, qëndrimeve, sjelljeve dhe vlerave që shoqëria ju atribuon burrave dhe grave. Pra “Gjinia” i referohet dallimeve të mësuara ndërmjet burrave dhe grave, përderisa “Seks” i referohet dallimeve biologjike ndërmjet gjinisë mashkullore dhe femërore. Rolet e gjinisë ndryshojnë mjaft brenda dhe përmes kulturave, dhe mund të ndryshojnë me kalimin e kohës. Gjinia nuk i referohet thjeshtë vetëm grave dhe burrave por gjithashtu edhe marrëdhënies ndërmjet tyre.

## Reforma mbi ligjet diskriminuese dhe promovimi i të drejtave njerëzore

- Shumë shtete akoma mbajnë ligjet të cilat janë hapurazi diskriminuese në lidhje me pronën e tokës, trashëgiminë (shih Shembullin 1), dhunën gjinore (GBV), kujdestarinë e fëmijëve, punësimin dhe çështje të tjera. Ligjet diskriminuese dhe normat duhet të reformohen në pajtim me ligjin internacional të të drejtave njerëzore.

## Paraqitje efektive dhe jo diskriminuese të shërbimeve juridike

- Qëndrime stereotipike, diskriminuese dhe bariera procedurale nuk duhet të gërmojnë zbatimin e shërbimeve juridike. I gjithë personeli gjyqësor duhet të pranojë stërvitje mbi çështjet e gjinisë, duke përfshirë përgjigje të duhura për dhunën familjare dhe diskriminimi në bazë të gjinisë ose orientimit seksual.
- Me qëllim që ti jepet fund jodënueshmërisë të dhunës bazuar mbi gjininë, drejtësia duhet të jetë e stërvitur sipas legjislacionit internacional dhe nacional mbi çështjet e gjinisë.

## Të sigurohet qasje e barabartë në drejtësi

- Burrat dhe gratë kanë të drejtë në qasje të barabartë në sistemet e drejtësisë, nëpërmjet gjykatave, mekanizmave të drejtësisë të tranzicionit, sistemeve tradicionale / të zakonshme dhe zgjidhje alternative të kontesteve. Sidoqoftë, ka shumë pengesa për qasjen e grave në drejtësi ku përfshihet: mungesa e diturisë rreth të drejtave ligjore, korupcionit, frika nga dëshmia, mungesa e burimeve, bariera gjuhësore dhe mungesa e kujdesit të fëmijës.

Fillimisht në vitin 2008 ky dokument u botua me titull «Toolkit on Gender and Security Sector Reform» nga ana e Zyrës për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut të OSBE-së (ODIHR), Qendra e Gjenevës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF) dhe Institutit Ndërkombëtar për Hulumtime dhe Trajnim për Avancimin e Femrave (UN-INSTRAW).

Jane Waitri i bëri kërkesë gjyqit që ti jepet vendimi gjyqësor asaj për një gjysëm parceli të tokës që i takonte babait të saj të vdekur në të cilën ajo kishte jetuar me katër fëmijët e saj. Vëllai i saj kundërshtonte, duke argumentuar se më tepër ai kishte kultivuar pjesën më të madhe të tokës derisa babai i tyre ishte gjallë, për dallim nga motra e tij kështu që atij i takonte e drejta e pjesës më të madhe të tokës.

Kryetari i Gjykatës H.A. Omondi tha se sipas ligjit të zakonshëm të Kikuyu, një grua e pamartuar si Waitri i mungonte e drejta për trashigimi të barabartë për arsye të shpresës se ajo mund të martohet. Gjykatësi Omondi tha se kjo dispozitë e zakonshme ishte diskriminuese ndaj grave sipas shkeljes së Nenit 82(1) të Kushtetutës së Kenisë, e cila ndalon diskriminimin në bazë të gjinisë. Gjithashtu e thyente Nenin 18(3) të Statutit të Banjullit dhe Nenin 15(1)-(3) të Kuvendit mbi Eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave (CEDAW), e cila siguron barazi ligjore ndërmjet burrave dhe grave. Si pasojë, Gjykatësi Omondi ia dha të drejtën Waitrit dhe vëllaut të saj për ndarje të barabartë të pronës së babait të tyre<sup>2</sup>.

### Sektori juridik përfaqësues dhe legjitim

- Nëse sektori juridik do të fiton kredibilitet dhe besim në sytë e bashkësisë, procesi i reformës duhet patjetër të përfshin pjesëmarrjen, dhe ti drejtoj nevojat, e të gjithë antarëve të shoqërisë duke përfshirë edhe gratë.
- Me qëllim të rritjes së pranueshmërisë, personeli i sektorit juridik duhet të jetë përfaqësues i popullatës që e shërben. Kohëve të fundit gratë janë shumë pak të përfaqësuara në me shumë nivele të sistemit juridik, duke përfshirë këtu profesionet e gjykatëseve dhe avokateve.

#### Pajtueshmëria me obligimet sipas ligjeve dhe dokumenteve ligjore internacionale

Marrja e iniciativës për ti shkruarë çështjet e gjinisë në reformën juridike nuk paraqet vetëm një çështje të efikasitetit punësor; gjithashtu është e nevojshme pajtim me ligjet internacionale dhe regjionale, dokumentat ligjore dhe normat që i përkasin sigurimit dhe gjinisë. Dokumentat ligjore kryesore përfshijnë:

- *Kuvendin mbi Eliminimin e të Gjitha Formave Diskriminuese Kundër Grave (CEDAW, 1979)*
- *Rezoluta e Mbledhjes Gjenerale të Kombeve të Bashkuara 52 / 86 mbi Parandalimin e Krimit dhe Masat e Drejtësisë Penale për të Eliminuar Dhunën Kundër Grave (1998)*

Për më tepër informata, ju lutem shihni Aneksin e Mjetit Praktik mbi Ligjet Internacionale dhe Regjionale dhe Dokumentat ligjore.

### Si mundet gjinia të integrohet në reformën të drejtësisë?

- Miratimi dhe ratifikimi i traktateve dhe kongreseve internacionale dhe regjionale për të drejtat njerëzore.
- Reformim i kushtetutës me qëllim që të garanton kënaqësi të barabartë të të drejtave njerëzore dhe barazi gjinore, dhe të ndalon diskriminimin gjinor dhe dhunën.
- Rishikim i legjisllacionit nacional egzistues dhe miratim i ligjeve të reja për të ndaluar diskriminimin gjinor dhe dhunën.
- Angazhim me mekanizmat juridike tradicionale për të garantuar që ato do të përkrahin të drejtat themelore njerëzore, duke përfshirë të drejtat e grave.

### Procedurat dhe zakonet jo – diskriminuese

- Shqyrtim i procedurave dhe zakoneve ligjore për të garantuar që ato nuk do të diskriminojnë pa të drejtë kundër grave ose grupe të tjera të shoqërisë.

### Masa të veçanta për t'ju drejtuar dhunës gjinore

- Themelimi i masave të veçanta, në lidhje me dhunën seksuale dhe familjare për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe viktimave dhe për rritjen e numrit të rasteve që do të shkojnë në gjykim. Masa të veçanta mund të përfshijnë role të gjinive të ndjeshme në provat dhe procedurat të cilat nuk janë të bazuara në stereotipe të dëmshëm dhe që shmangin “ri-përndjekjen” e të mbijetuarve ( shih Kutinë e II ).

### Stërvitja e gjinive

- Paraqitja e stërvitjes për të drejtat e grave ( e nxjerrë nga ligjet dhe detyrimet nacionale, regjionale dhe internacionale ), procedura ligjore për dhunën e bazuar në gjini (GBV) dhe ndikimi “ gjinor” i sistemit ligjor për të gjithë aktorët brenda në sektorin ligjor, duke përfshirë: gjykatësit, prokurorët, këshillin mbrojtës, avokatët privat, personelin e gjyqit, policinë dhe praktikantët.

### Mundësi për qasje në drejtësi

- Punësim i praktikantëve për të krijuar mundësinë e shkrimit dhe leximit të popullatës së përgjithshme nëpërmjet të mësuarit e njerëzve se si të hynë në sistemin e drejtësisë, cilat janë të drejtat e tyre ligjore dhe si ti përdorin burimet ligjore që janë në dispozicion.
- Sigurim i ndihmës ligjore për popullatën e marginalizuar, duke përfshirë gratë.
- Përkrahje e organizatave të shoqërive civile (CSO), duke përfshirë organizatat e grave, që ndihmojnë hyrjen në drejtësi (shih Shembulli e III).

#### Shembulli 2 | Mekanizma të veçantë për viktimat e dhunës seksuale në Afrikën e Jugut

Si përgjigje për numrin e ulët të dënimeve, Afrika Jugore prezantoi Gjykatat për kundërvajtje në lidhje me Krimet Seksuale dhe qendrat Thuthuzela. Gjykatat për Krime Seksuale janë gjykata të specializuara dhe të dizajnuara të kufizojnë trajtimin dhe rastet akuzuese të abuzimit seksual; i gjithë personeli ka qenë veçanërisht i stërvitur të ballafaqohet me krimet seksuale. Thuthuzela, ose qendrat për pranim janë të lidhura me këto gjykata dhe shërbejnë si shërbim ndalues për viktimat e përdhunimit. Një qendër është e drejtuar nga një projekt menaxher dhe siguron shërbime policore, kujdesje shëndetësore, këshillim dhe shërbime ligjore të gjitha në një vend, duke mundësuar udhëheqje të përmisuar të rasteve të përdhunimit. Numri i dënimeve është rritur deri në 75-95% dhe një rast i veçantë tani zgjidhet brenda 6 muajve prej datës së parë të denoncimit. Para këtyre qendrave, zgjidhja e një rasti mirrte mesatarisht 18 muaj deri në 2 vjet.<sup>3</sup>

## Sektori ligjor përfaqësues

- Promovim i përfaqësimit të barabartë të grave dhe burrave në sistemin juridik nëpërmjet iniciativave deri në ngritje të angazhimit të femrës, ruajtje dhe përparim. Masa speciale të përkohshme, ose veprime pohuese, siç janë: bursa ligjore ose mund të nevojiten kuota për të shpejtuar progresin drejt barazisë (shih Shembullin e IV).

## Mbikëqyrja dhe vëzhgimi

- Përfshirja e anëtarëve kryesorë nga gjykata, person kompetent nga akuza, shoqatat ligjore, policisë, burgjet, shoqërisë civile, rrjetet e grave dhe organizatat jo qeveritare (NGOs) në proceset e reformës juridike.
- Forcimi i përgjegjësisë gjinore internacionale, mekanizmat e mbikëqyrjes dhe vëzhgimit të shoqërisë nacionale dhe civile. Për shembull, makineria nacionale e grave ose forca e punës me paragjykim ndaj gjinisë nëpër gjyqe mund të punon për të mbajtur sistemin juridik përgjegjës për eliminimin e paragjykit ndaj gjinisë në gjyqe, diskriminimin në trupin gjykues, ose ndjekje penale të gabuara ndaj rasteve të dhunës gjinore (GBV).

### Gjithashtu në dispozicion në Mjetin 4...

- 'Nëntë Ps të Reformës Gjinike dhe Juridike'
- Zakonet më të mira në definicionin ligjor dhe kriminalizimin e përdhunimeve
- Këshilla për themelimin e forcës së punës për paragjykim gjinor në gjykata
- Stërvitje të mira për angazhim me mekanizmat juridik tradicionale
- Këshilla për integrim të gjinisë në Komisionet e të Vërtetës dhe Pajtimin.

## Sfidat dhe mundësitë pas konfliktit

Periodha pas konfliktit paraqet një mundësi ideale për të adoptuar strategjitë për rithemelimin e rregullit të ligjit dhe promovimin e barazisë gjinore brenda sektorit juridik, si dhe pjesëmarrjen direkte të grave gjatë tërë procesit të reformës juridike. Proçesi i paqes dhe tranzicionit nga konflikti janë pika hyrëse strategjike për të promovuar përgjegjësinë për dhunën gjinore (GBV) dhe diskriminimin. Mekanizmat juridike tranzicionale, siç janë: gjykata penale, komisionet e të vërtetës dhe pajtimin dhe programet e shpërblimit, shpesh paraqesin faktorë të rëndësishëm në këtë përpjekje.

### Shembulli 3 Rritja e mundësisë për hyrje publike dhe vetëdijes në Timor Leste

Në Timor Leste, Fokupers, një organizatë jo qeveritare, siguron shërbime ndihmëse ligjore të arritshme për viktimat e gjinisë femërore dhe rrit vetëdijen publike rreth dhunës familjare dhe të drejtat ligjore të grave. Broshurat me informata të saj shpërndahen te ekonomatët e shërbimit, institucionet fetare, agjencitë qeveritare dhe ligjvënësit.<sup>4</sup>

## Sfidat për integrimin e çështjeve gjinore

- Drejtësia shpesh është jofunkionale, pavarësia e saj është e kompromentuar dhe e korruptuar me tepriçë
- Shumë konflikte përfshinë dhunë masive seksuale kundër grave dhe vajzave, dhe gjithashtu kundër burrave dhe djemve, e cila nevojitet të drejtohet posaçërisht në reformën juridike të pas konfliktit. 6 Dhuna seksuale dhe familjare shpesh vazhdojnë në numra të lartë pas konfliktit; mekanizmat juridike që duhet ti drejtohen dhunës gjinore (GBV) janë një prioritet urgjent.
- Policia dhe sistemi penal janë pjesë e këtij problemi: policia nuk ka kapacitetin ose vullnetin që me efikasitet ti përgjigjet rasteve të dhunës gjinore (GBV) dhe burgjet janë të mbingarkuara dhe me abuzim të tepërt.
- Popullata e zakonshme, veçanërisht gratë, shpesh nuk kanë besim në sistemin juridik.

## Mundësitë për integrimin e çështjeve gjinore

- Ndoshta ka më tepër vullnet politik në bashkësinë internacionale, organizatat internacionale dhe qeveritë e sapo formuara për të investuar në proceset e reformës juridike të përgjegjësisë gjinore.
- Proçesi i ndërtimit të paqes mund të krijojë pika hyrëse për pjesëmarrje direkte të grave dhe tjerë anëtarë kryesorë në procesin e reformës juridike, duke ju dhënë atyre mundësinë për ti shprehur nevojat dhe prioritetet e tyre.
- Proceset e reformës juridike hapin mundësinë për të siguruar stërvitje të gjinive dhe anëtarësimin e më tepër grave dhe grupe të tjera të pa përfaqësuar.
- Mund të ketë përkrahje të shtrirë plotësisht për themelimin e mekanizmave juridike tranzicionale, të cilat sigurojnë një mundësi për inkorporimin e çështjeve gjinore, duke përfshirë me efikasitet ndjekjen penale të dhunës gjinore (GBV).

### Shembulli 4 Më tepër gjykatëse në Gjyqin European për Të Drejtat Njerëzore.

Kuvendi i Parlamentit European në Vendimin 1366 (2004) vendosi që më të mos i konsideron listat e kandidatëve për Gjyqin European të të Drejtat Njerëzore të cilat nuk përmbajnë së paku një kandidat prej secilës gjini. Ky rregull u ndryshua një vit më vonë që të mundësojë lista me kandidatë prej të dy gjinive, duke siguruar që ata të jenë nga gjinia më pak e përfaqësuar në Gjykatë (përkatësisht gratë). Kur u vendos për këtë masë, kishite 11 gjykatëse me 32 gjykatës: gratë përbënin vetëm 26% të përbërjes së Gjyqit. Pasiqë në Prill 2007, situata ishte përmisuar, edhe pse vetëm pak: atje kishite 14 gjykatëse me 32 gjykatës; gratë përbënin 30% të përbërjes së Gjyqit.<sup>5</sup>



## Pyetjet për reformën juridike

Një nga mënyrat më të mira për të identifikuar pikat hyrëse, përforsimet dhe mangësitë për inkorporimin e perspektivave gjinore në reformën juridike është të sillt një vlerësim, vëzhgim dhe evaluim më i plotë.

- Cilat instrumente të të drejtave njerëzore internacionale dhe regjionale kanë qenë të ratifikuara?
- A përputhen kushtetuta dhe ligjet nacionale me obligimet e të drejtave njerëzore internacionale dhe regjionale, duke përfshirë për sa i përket barazisë gjinore dhe dhunës gjinore (GBV)?
- A përfshijnë praktikime diskriminuese ligjet dhe zakonet tradicionale dhe fetare?
- A janë ligjet adekuate në vend për të parandaluar diskriminimin – p.sh. ligjet që ndalojnë: diskriminimin kundër grave dhe burrave me HIV/AIDS; diskriminim ose pushim nga puna në bazë të shtatzënisë, pushimit të lindjes ose martesës; si dhe shqetësim seksual në vendin e punës?
- A ka de fakto dhe/ose ligjërisht diskriminim në ligjet ose në mënyrën se si ato aplikohen?
- A kanë gratë dhe burrat, në vendet rurale dhe urbane hyrje të plotë dhe të barabartë në sistemin juridik?
- A janë programet ligjore për shkrim dhe lexim për përgjegjësinë gjinore në vend të duhur?
- A janë rastet e dhunës gjinore (GBV) mjaftueshëm të përpunuara dhe të sanksionuara? A janë në vend të duhur mekanizmat e vecantë për ti mbrojtur dhe përkrahur dëshmitarët dhe viktimat?

- A kanë pranuar stërvitje gjinore të duhur i gjithë personeli i sektorit juridik?
- A kanë kundërvajtësit e gjinisë femërorë hyrje të barabartë për alternativat e burgimit?
- A është buxheti i sektorit juridik për përgjegjësinë gjinore, si përfshirja e fondeve për stërvitjen gjinore ose ndihma ligjore për gratë?
- A janë dëftesat dhe procedurat në vend të duhur për të rritur përfaqësimin e barabartë të burrave dhe grave në sistemin juridik?
- A janë CSO, duke përfshirë grupet e grave, plotësisht të përfshira në proceset e reformës juridike dhe mbikëqyrjes dhe trupat vëzhgues?

## Më tepër informata

### Burimet

ARC internacional – *Ndihma Ligjore Për Dhunën Gjinore: Koleksion I procedurave Pjesëmarrëse*, 2005.

ILAC – *Krijim I Bashkëpunimeve për Promovim të të Drejtës Gjinore në Shoqëritë Pas-Konfliktit*, 2005.

Molyneux, M. & Razavi, S. – *E Drejta Gjinore, Zhvillimi dhe Të Drejtat*, 2003.

Nessiah, V. Qendra Internacionale për Të Drejtën Tranzicionale – *Seri të Të drejtave Gjinore, Komisionet e të Vërtetës dhe Gjinisë: Principet, Dëftesat dhe Procedurat*, 2006.

OECD DAC – *OECD DAC Manual mbi Reformën e Sistemit të Sigurisë – Përkrahja e Sigurisë dhe Drejtësisë*, 2007.

Qendra e Teksasit për Etikën Ligjore dhe Profesionalizmin – *Direktivat për Procedurat Gjyqësore Neutrale të Gjinisë*, 2001.

UNDOC – *Mjet Praktik për Vlerësimin e të Drejtës Penale*, 2006.

Banka Botërore – *E drejta e Gjinisë dhe Komisionet e të Vërtetës*, 2006.

### Organizatat

Partneriteti I Ndihmës Ligjore Internacionale – [www.ilac.se](http://www.ilac.se)

ICTJ – [www.ictj.org](http://www.ictj.org)

### Gjinia dhe Mjeti Praktik i RSS-it

1. Reforma e Sektorit të Sigurisë dhe Gjinia
2. Reforma Policore dhe Gjinia
3. Reforma Mbrojtëse dhe Gjinia
4. Reforma e Drejtësisë dhe Gjinia
5. Reforma Penale dhe Gjinia
6. Drejtuesit e Kufirit dhe Gjinia
7. Mbikëqyrje Parlamentare e Sektorit të Sigurisë dhe Gjinia
8. Sigurimi Nacional I Krijimit të Dëftesës dhe Gjinia
9. Mbikëqyrje e Shoqërisë Civile mbi Sektorin e Sigurimit dhe Gjinia
10. Ushtria Private dhe Kompanitë e Sigurimit dhe Gjinia
11. Vlerësimi I SSR, Vëzhgim dhe Evaluim dhe Gjinia
12. Stërvitje Gjinore për Personelin e Sektorit të Sigurimit Aneks mbi Ligjet Internacionale dhe Regjionale dhe Dokumentet Ligjore

Secila nga këto Mjete dhe Konspekte Praktike janë në dispozicion në: [www.dcaf.ch](http://www.dcaf.ch) [www.un-instraw.org](http://www.un-instraw.org) dhe [www.osce.org/odihr](http://www.osce.org/odihr).

**Ky Konspekt Praktik u përgadit nga Nadia Nieri nga UNINSTRAW, e bazuar mbi Mjetin 4 e shkruar nga Shelby Quast.**

<sup>1</sup> Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Sigurim, OECD DAC Manual mbi Reformën e Sistemit të Sigurimit: Përkrahja për Sigurimin dhe Drejtësinë, Botim në Skicë, (OECD:Paris),2007, f. 182.

<sup>2</sup> Shoqata Internacionale e Grave Gjykatëse, 'Jurisprudencë e Programeve për Vendime të Barabarta' <http://www.iawj.org/jep/jep.asp>

<sup>3</sup> Qendrat për Kujdesje të Thuthuzela, Strategjia e Shtetie për Anti-Përdhunim Përmirëson Numrat e Ndjekjeve Penale Të Autorëve të Krimin, 8 Maj 2006. <http://www.npa.gov.za/Read Content 407.aspx>

<sup>4</sup> Në Studim të Thellë mbi të gjitha format e Dhunës Kundër Grave, Raport I Sekretarit-Gjeneral ( 6 Korik 2006), document I KB A/61/122/Add.1, para. 299.

<sup>5</sup> Raport nga Simpoziumi Internacional mbi Dhunën Seksuale gjatë Konfliktit dhe Më Tej, 21-23 Qershor 2006, Bruksel, Palata e Egmont. [http://www.unfpa.org/emergencies/symposium06/docs/final\\_report.pdf](http://www.unfpa.org/emergencies/symposium06/docs/final_report.pdf) Raport nga Simpoziumi Internacional mbi Dhunën Seksuale gjatë Konfliktit dhe Më Tej, 21-23 Qershor 2006, Bruksel, Palata e Egmont. [http://www.unfpa.org/emergencies/symposium06/docs/final\\_report.pdf](http://www.unfpa.org/emergencies/symposium06/docs/final_report.pdf)

<sup>6</sup> Bastick, M. Grimm, K. & Kunz, R., Dhuna Seksuale në Konfliktet e Luftës: Rishikim Global dhe Implikacionet për Sektorin e Sigurimit, (DCAF: Gjenevë), 2007.